

**KËSHILLI I INVESTIMEVE
PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË
MBLEDHJES XXXVIII**

***KONSULTIMI I
DOKUMENTIT POLITIK PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME
2026–2030
DHE
STRATEGJISË KOMBËTARE TË INDUSTRISË 2026–2030 DHE PLANIT TË SAJ
TË VEPRIMIT***

Tiranë, 30 qershor 2026, 16:00 – 17:30

Mbledhja u ndoq nga Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Martin Kajo, në mungesë të Kryetares së Këshillit të Investimeve dhe Ministres së Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, për shkak të një mbledhjeje të jashtëzakonshme në Kryeministri. Në mbledhje morën pjesë 17 anëtarë të KI dhe 20 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj, si dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

I. Hapja e Mbledhjes

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, hapi mbledhjen duke përcjellë ndjesën e Kryetares së Këshillit, Ministres Delina Ibrahimaj, për mungesën e saj në mbledhje për shkak të angazhimit në një mbledhje të jashtëzakonshme në Kryeministri.

Më tej, u prezantua qëllimi i mbledhjes, i cili konsistonte në konsultimin me anëtarët e Këshillit mbi dy dokumente strategjike për rritjen e konkurrueshmërisë së vendit: Dokumentin e Politikave për NVM-të 2026–2030 dhe Strategjinë Kombëtare të Industrisë 2026–2030, të publikuara për konsultim publik nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në fillim të qershorit 2026. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre, Kryetarja e Këshillit kishte propozuar zhvillimin e kësaj mbledhjeje me qëllim mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve nga sektori privat.

Një javë përpara mbledhjes, Sekretariati kishte shpërndarë materialet dhe përmbledhjet përkatëse tek anëtarët, duke i ftuar ata të paraqisnin komentet në Regjistrin e Konsultimit Publik ose pranë Sekretariatit të Këshillit. Deri në ditën e mbledhjes, Sekretariati kishte marrë komente me shkrim nga Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA) dhe ProExport Albania (PEA),¹ ndërsa ekspertët e Sekretariatit kishin përgatitur gjithashtu disa komente bazuar në punën e tyre në këto fusha, të cilat u prezantuan gjatë mbledhjes.

Në vijim, fjala iu dha Zëvendësministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Martin Kajo, për prezantimin e dy dokumenteve strategjike.

II. Prezantim: Shtyllat kryesore të draft strategjisë kombëtare të Industrisë dhe udhëzuesit të politikave të NVM-ve

¹ Komente zyrtare u dërguan gjithashtu me e-mail nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FLAA), Confindustria Albania, pas mbledhjes, më 2 korrik 2026.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, prezantoi shkurtimisht draft Strategjinë Kombëtare Industriale 2026–2030 dhe draft Dokumentin e Politikave për Zhvillimin e NVM-ve 2026–2030, të hartuara nga një grup ndërinstitucional pune i udhëhequr nga Ministria, me mbështetjen e GIZ. Ai theksoi se të dy dokumentet janë pjesë e përmbushjes së detyrimeve të Kapitullit 20 të negociatave me BE-në dhe synojnë forcimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare.

Më tej ai sqaroi se Strategjia Industriale vepron në nivel makro dhe sektorial, duke orientuar transformimin e industrisë shqiptare deri në vitin 2030, integrimin në zinxhirët evropianë të vlerës, dekarbonizimin, digjitalizimin dhe ndërtimin e ekosistemeve industriale. Dokumenti i Politikave për NVM-të vepron në nivel horizontal, duke adresuar aftësitë e ndërmarrjeve, inovacionin, digjitalizimin, mjedisin rregullator dhe aksesin në financë.

Gjatë prezantimit, ai evidentoi disa sfida strukturore të ekonomisë shqiptare, si pesha e ulët e industrisë përpunuese në PBB, niveli i ulët i eksporteve me teknologji të mesme dhe të lartë, investimet e kufizuara në kërkim & zhvillim, lidhja e dobët midis universiteteve dhe industrisë, si dhe fragmentimi institucional. Për NVM-të ai theksoi sfidat në aftësi, digjitalizim, inovacion, akses në financë dhe ndërkombëtarizim.

Z. Kajo prezantoi gjithashtu objektivat strategjike dhe masat kryesore të parashikuara në të dy dokumentet, përfshirë programin kombëtar të tranzicionit industrial, skemat e dekarbonizimit, parqet eko-industriale, vauçerët për inovacion, programin kombëtar të transformimit digjital, përmirësimin e cilësisë rregullatore, institucionalizimin e SME Test, zhvillimin e shërbimeve publike digjitale dhe zgjerimin e instrumenteve të financimit për ndërmarrjet.

Në përfundim, ai ftoi anëtarët e Këshillit dhe palët e interesuara të japin komente dhe sugjerime mbi të dy dokumentet strategjike. Ai theksoi se, gjatë procesit të konsultimit publik, të gjitha komentet e paraqitura – përfshirë ato nga përfaqësuesit e sektorit privat – merren në shqyrtim dhe trajtohen në mënyrë të rregullt. Ai nënvizoi se politikëbërësit japin përgjigje të argumentuara për çdo koment, duke sqaruar nëse ai pranohet apo jo, çka e bën procesin transparent dhe konstruktiv, me qëllim përmirësimin e politikave publike.

III. Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Z. Edvin Prençe, Shoqata Pro-Eksport Albania (PEA), falenderoi organizatorët për eventin dhe Këshillin e Investimeve, ekspertët si dhe Ministrinë për përgatitjen dhe diskutimin e strategjisë. Ai vlerësoi procesin e konsultimit, por theksoi se strategjia aktuale është e cunguar dhe ka mungesa të rëndësishme.

Ai ngriti disa shqetësime kryesore, duke përfshirë mungesën e përcaktimit të qartë të sektorëve prioritarë që preken apo do të mbështeten në kuadër të politikës “Made in Albania”, si dhe mungesën e qartësisë mbi kostot dhe mekanizmat e zbatimit dhe shpërndarjes së fondeve, përfshirë rolin e AIDA-s. Në këtë kontekst, ai përmendi edhe mungesën e informacionit lidhur me një fond të dedikuar për digjitalizim mbi mënyrën e shpërndarjes së tij dhe sektorët që mbulon.

Ai theksoi se Shqipëria nuk ka pasur mungesë strategjish, por më tepër mungesë të vullnetit politik për zbatimin e tyre, duke nënvizuar ndikimin negativ që kjo situatë ka pasur mbi eksportet dhe sektorin e prodhimit. Në përfundim, ai kërkoi që strategjia të mos mbetet vetëm udhëzuese, por të ketë karakter detyrues dhe realisht të zbatohet, në mënyrë që të ketë besueshmëri nga biznesi dhe efekt konkret në ekonomi.

Z. Grant Van Cleve, AmCham, vuri në dukje se Shqipëria përballet vazhdimisht me sfida jo në nivel strategjik, por në zbatimin praktik të tyre. Ai theksoi se, ndonëse ekziston rreziku që këto komente të tingëllojnë kritike, është e rëndësishme të nënvizohet edhe puna e konsiderueshme që është bërë nga të dy palët, si dhe nevoja për përafrimin e shpejtë me legjislacionin e BE-së.

Ai shprehu shqetësim se dokumentet strategjike duhet të shoqërohen me plane të qarta zbatimi, tregues performance (KPIs) dhe struktura monitorimi. Në këtë kontekst, ai ngriti pyetje mbi mënyrën e matjes dhe vlerësimit të rezultateve, si dhe mbi ndërveprimin transparent me komunitetin e biznesit.

Duke iu referuar Indeksit të Biznesit të AmCham, ai përmendi një rënie prej rreth 15% në perceptimin e klimës së biznesit nga anëtarët e Dhomës, duke e konsideruar këtë si një sinjal shqetësues. Në përfundim, ai theksoi se, megjithëse AmCham ka një listë të gjerë propozimesh konkrete për përmirësim, ato mund të adresohen vetëm nëse qeveria është e gatshme të forcojë zbatimin praktik të legjislacionit dhe politikave.

Znj. Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, vlerësoi organizimin e tryezës dhe rëndësinë e dy dokumenteve strategjike, veçanërisht në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Ajo theksoi se, megjithëse strategjitë përbëjnë një hap të rëndësishëm, ato ende përmbajnë boshllëqe që duhet të adresohen dhe njoftoi se komentet e detajuara do të përcillen edhe me shkrim.

Ajo propozoi që rritja e konkurrueshmërisë industriale të vendoset si objektiv horizontal i të dy strategjive, duke u shoqëruar me masa konkrete për rritjen e produktivitetit, modernizimin teknologjik, rritjen e vlerës së shtuar dhe diversifikimin e bazës industriale. Gjithashtu, rekomandoi që politikat industriale të organizohen sipas ekosistemeve industriale, në përputhje me qasjen e Bashkimit Evropian, duke identifikuar ekosisteme prioritare si agropërpunimi, tekstilet dhe këpucët, materialet e ndërtimit, industria farmaceutike, pajisjet mjekësore, ekonomia blu dhe industritë kreative.

Më tej, ajo theksoi nevojën për forcimin e reziliencës së zinxhirit të furnizimit, zgjerimin e instrumenteve të aksesit në financë, si fondet e garancisë, kapitali sipërmarrës dhe biznes angels, si dhe zgjerimin e konceptit të digjitalizimit për të përfshirë Industrinë 4.0, automatizimin, robotikën, inteligjencën artificiale dhe teknologjitë cloud.

Në vijim, znj. Muçostepa kërkoi që strategjitë të përfshijnë objektiva konkrete për tranzicionin e gjelbër, ekonominë qarkulluese dhe përdorimin efikas të burimeve natyrore, si edhe masa për forcimin e ekosistemit të inovacionit përmes bashkëpunimit ndërmjet universiteteve, instituteve kërkimore, industrisë dhe start-up-eve. Ajo nënvizoi gjithashtu rëndësinë e ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve, integritimit në zinxhirët evropianë të vlerës, promovimit të investimeve, zhvillimit rajonal, zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe harmonizimit të plotë të strategjive me politikat dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, vlerësoi komentet e paraqitura dhe sqaroi se një pjesë e madhe e çështjeve dhe propozimeve të ngritura janë tashmë të trajtuara dhe të reflektuara në analizën dhe masat e parashikuara në dokumentet strategjike.

Znj. Ritva Heikkinen, Delegacioni i BE-së, falenderoi organizatorët për zhvillimin e konsultimit dhe njoftoi se të dy dokumentet strategjike janë aktualisht në proces shqyrtimi në Bruksel, ndërsa komentet zyrtare do të përcillen në një fazë të mëvonshme.

Ajo theksoi se strategjitë duhet të shërbejnë si instrumente zbatimi dhe jo si dokumente të pavarura politike, duke nënvizuar nevojën për plane të qarta veprimi, buxhete, tregues të performancës (KPI) dhe mekanizma monitorimi. Sipas saj, këto strategji përbëjnë një nga kriteret për mbylljen e

Kapitullit 20 (Ndërmarrjet dhe Politika Industriale) në procesin e anëtarësimit në BE dhe, si të tilla, duhet të fokusohen në zbatim efektiv.

Ajo rikujtoi gjithashtu diskutimet e mëparshme me Komisionin Evropian lidhur me mundësinë e integritetit të Strategjisë Industriale me Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, në vend të mbajtjes së dy dokumenteve të veçanta. Në rast se Qeveria vendos t'i mbajë të ndara, ajo theksoi nevojën për një arsytim të fortë drejtuar Komisionit Evropian, duke paralajmëruar se strategjitë e shumta mund të krijojnë mbivendosje, dublikim masash dhe ngarkesë shtesë administrative në zbatim dhe monitorim.

Gjithashtu, ajo inkurajoi forcimin e përputhjes me prioritetet industriale të BE-së, me fokus më të madh në reziliencë, ekosistemet industriale prioritare dhe qartësimin e rolit të investimeve të huaja direkte dhe zhvillimit të ndërmarrjeve vendase. Në fund, ajo rekomandoi përfshirjen në strategji të reformës së planifikuar të kuadrit ligjor të investimeve, përfshirë Ligjin e Unifikuar të Investimeve, duke e cilësuar si një prioritet kyç të BE-së në kuadër të Agjendës së Reformave, me synim miratimin e tij deri në dhjetor 2026 për të garantuar një kuadër të unifikuar ligjor dhe trajtim të barabartë për investitorët vendas dhe të huaj.

Znj. Silva Meçaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, propozoi që strategjitë të adresojnë në mënyrë më të qartë rolin e biznesit të diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo theksoi rëndësinë e krijimit të mekanizmave për bashkëpunim ndërmjet bizneseve vendase dhe sipërmarrësve të diasporës, me synim nxitjen e investimeve në sektorë si pasuritë e paluajtshme, turizmi, bujqësia dhe teknologjia, si edhe lehtësimin e hyrjes në tregjet ndërkombëtare. Gjithashtu, ajo vuri në dukje se dokumentet strategjike nuk trajtojnë bashkëpunimin me bizneset e diasporës dhe ndërveprimin ndërmjet bizneseve shqiptare dhe atyre të diasporës, pavarësisht potencialit të tyre për të nxitur investimet dhe për të kontribuar në zhvillimin e industrisë, bujqësisë dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare.

Z. Bardhyl Baltëza, Edipack sh.p.k./Shoqata e Ricikluesve, falenderoi për organizimin e mbledhjes dhe theksoi nevojën për një diskutim më të thelluar mbi temat e trajtuara. Ai ngriti shqetësimin se strategjia nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme ekonomisë qarkulluese, pavarësisht rëndësisë së saj në politikat evropiane dhe detyrimeve të rritura për riciklim, duke përmendur objektivat ambicioze të BE-së për rritjen e normave të riciklimit.

Ai argumentoi se industria prodhuese në Shqipëri përballlet me kosto shumë të larta të energjisë elektrike (rreth 23 cent/kWh krahasuar me rreth 9 cent në vendet e rajonit si Greqia) dhe me kosto të larta të gazit LPG (rreth 1,250 euro/ton, krahasuar me rreth 500 euro/ton në rajon). Sipas tij, këto diferenca të mëdha e bëjnë prodhimin vendas jo konkurrues, duke ndikuar negativisht në eksportet dhe punësimin, si dhe duke kontribuar në largimin e të rinjve, pasi bizneset e kanë të vështirë të rrisin pagat. Ai theksoi se, ndryshe nga 10–15 vite më parë, kur kompania e tij eksportonte 30–40% të prodhimit në Itali, Greqi dhe vendet e rajonit, sot fabrika e letrës operon vetëm rreth 10 ditë në muaj, çka sipas tij lidhet me kostot e larta të prodhimit dhe kuadrin ligjor që kufizon importin e mbetjeve për riciklim.

Ai kritikoi legjislacionin aktual në sektorin e riciklimit, duke theksuar se Shqipëria, sipas tij, është i vetmi vend që ndalon importin e mbetjeve për riciklim, ndërkohë që lejon eksportin e tyre. Si shembull, ai përmendi se disa kompani në Shqipëri eksportojnë letër për riciklim në Serbi, duke argumentuar se kjo politikë dëmton industrinë vendase të riciklimit.

Në vijim, ai kërkoj që të adresohen problemet strukturore të industrisë, përfshirë kostot e larta të transportit dhe mungesën e infrastrukturës efikase (p.sh. mungesa e hekurudhave dhe vonesat në transport), si faktorë që rrisin humbjet dhe pengojnë zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë e përgjithshme të sektorit prodhues.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, falenderoi për komentet dhe theksoi se qëllimi i konsultimeve është pikërisht përmirësimi i dokumenteve strategjike. Ai sqaroi se elementët e ekonomisë qarkulluese dhe asaj të gjelbër janë tashmë të integruara në strategji, si pjesë e një kuadri më të gjerë objektivash që lidhen me rritjen e produktivitetit, dekarbonizimin e ekonomisë dhe promovimin e praktikave qarkulluese në sektorë të ndryshëm. Sipas tij, këto nuk trajtohen si komponentë të veçantë të izoluar, por si pjesë e transformimit të përgjithshëm të modelit ekonomik.

Ai nënvizoi se strategjia synon të orientojë ekonominë shqiptare drejt një modeli më modern dhe konkurrues, të bazuar në rritjen e produktivitetit, digjitalizimin, tranzicionin e gjelbër dhe nxitjen e inovacionit. Në këtë kuadër, dokumenti synon të shërbejë si një kornizë udhëzuese për transformimin strukturor të ekonomisë.

Gjithashtu, ai theksoi se strategjia nuk është vetëm një dokument orientues, por përmban masa konkrete të shoqëruara me objektiva të matshëm, tregues performance (KPIs) dhe një plan veprimi të kostuar. Ky plan përfshin afate kohore dhe buxhete të përcaktuara, ndërsa detajimi i mëtejshëm i masave dhe instrumenteve do të vijojë në fazat pasuese të konsultimit publik.

Z. Bardhyl Baltëza, Edipack sh.p.k./Shoqata e Ricikluesve, theksoi se kuadri ligjor për ndarjen në burim të mbetjeve urbane mbetet ai i vitit 1995, duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur përparim të mjaftueshëm në zbatimin dhe përditësimin e tij. Ai solli si shembull sektorin e riciklimit të letrës, duke theksuar se nga tre fabrikat e riciklimit që operonin rreth 15 vjet më parë, sot ka mbetur vetëm kompania e tij, falë faktit që operon me cikël të mbyllur të prodhimit (prodhim letre, kartoni dhe kutish). Gjithashtu, ai shtoi se mungesa e riciklimit të plastikës dhe djegia e materialeve të riciklueshme, si letra dhe plastika, në landfillle tregojnë nevojën për politika më të hapura dhe më efektive për menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve.

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, vlerësoi se shqetësimet e ngritura nga z. Baltëza ishin në të njëjtën linjë me komentet e mëparshme të përfaqësuesve të biznesit, duke theksuar nevojën që analiza e strategjisë të marrë më shumë në konsideratë sektorët konkretë të ekonomisë. Ajo sugjeroi që të vlerësohen kostot dhe sfidat me të cilat përballen sektorët gjatë procesit të transformimit dhe integritimit në tregun evropian, në mënyrë që të identifikohen potencialet dhe nevojat specifike të secilit sektor.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, sqaroi se strategjia nuk kufizohet vetëm në një analizë makroekonomike, por vendos si objektiv të parë strategjik forcimin e bazës prodhuese dhe orientimin e ekonomisë drejt tranzicionit të gjelbër dhe digjital. Ai shpjegoi se dokumenti parashikon trajektore të tranzicionit industrial dhe mekanizma për identifikimin dhe mbështetjen e ekosistemeve industriale, në përputhje me qasjen dhe taksonominë e Bashkimit Evropian.

Ai theksoi se në këtë fazë strategjia nuk synon të përzgjedhë sektorë specifikë për mbështetje, por të krijojë mekanizmat dhe proceset përmes të cilave institucionet dhe aktorët përkatës do të identifikojnë, vlerësojnë dhe mbështesin ekosistemet prioritare në vijim të zbatimit të politikës industriale.

Z. Bardhyl Baltëza, Edipack sh.p.k./Shoqata e Ricikluesve, solli si shembull gazin natyror në Delvinë, i cili sipas tij është pastruar nga një kompani e huaj për shkak të përmbajtjes së squfurit dhe për të cilin janë lidhur edhe kontrata me prodhuesit. Ai argumentoi se ky gaz do të ishte më i leverdishëm për industrinë, pasi është rreth 25% më efikas se LPG-ja dhe mund të ofrojë kosto më të ulëta, duke krahasuar çmimet e LPG-së me ato të gazit natyror/lëngshëm natyror. Ai shprehu shqetësimin se strategjia nuk adreson shfrytëzimin e këtij potenciali, ndonëse energjia përbën një nga kostot kryesore për sektorin prodhues.

Ai ritheksoi se çmimet e larta të energjisë elektrike dhe të karburanteve e bëjnë industrinë shqiptare jo konkurruese dhe argumentoi se nevojiten politika publike për uljen e kostove të energjisë për prodhuesit, edhe nëse kjo kërkon mbështetje nga buxheti i shtetit. Sipas tij, një politikë e tillë do të rriste prodhimin, produktivitetin dhe investimet në industri.

Gjithashtu, ai ngriti shqetësimin për mungesën e kapaciteteve të përpunimit të naftës në vend, duke e krahasuar situatën me vendet e rajonit, si Maqedonia e Veriut, dhe theksoi se kostot e transportit përbëjnë një barrë shtesë për biznesin dhe ndikojnë negativisht në konkurrueshmërinë e industrisë.

Z. Nikolin Jaka, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, falenderoi Këshillin e Investimeve për krijimin e një platforme të përhershme dialogu ndërmjet institucioneve publike, shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë, si dhe vlerësoi mbështetjen e GIZ dhe punën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për hartimin e Strategjisë Kombëtare Industriale dhe Dokumentit të Politikave për NVM-të.

Ai theksoi se strategjitë duhet të japin sinjale të qarta për investorët mbi drejtimin e zhvillimit ekonomik të vendit dhe të bazohen në një analizë të thelluar të potencialeve dhe avantazheve konkurruese të Shqipërisë. Duke iu referuar shqetësimeve të ngritura nga përfaqësuesit e industrisë, ai argumentoi se shumë sektorë prodhues po humbasin konkurrueshmërinë për shkak të kostove të larta të prodhimit, duke përmendur si shembull industrinë e qumështit, e cila sipas analizave rezulton të ketë kosto rreth 40% më të larta se në vendet e Bashkimit Evropian dhe të rajonit. Sipas tij, biznesi ka nevojë për orientime të qarta mbi sektorët prioritarë dhe politikat industriale që do të mbështeten nga qeveria.

Z. Jaka ngriti shqetësimin se vendimmarrja publike shpesh fokusohet në ndikimin afatshkurtër fiskal, në vend që të mbështesë politika që rrisin konkurrueshmërinë e ekonomisë. Në këtë kuadër, ai përmendi nevojën për uljen e kostove të energjisë dhe gazit për industrinë, uljen e TVSH-së për industrinë ushqimore në nivele të krahasueshme me vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian, si dhe zgjerimin e programeve të mbështetjes financiare për fermerët dhe sektorin prodhues.

Ai theksoi gjithashtu se bizneset përballen me kosto të larta operimi, barriera burokratike, mungesë të analizave mbi konkurrencën rajonale dhe sfida të konsiderueshme për përmbushjen e standardeve të ekonomisë qarkulluese dhe tranzicionit të gjelbër. Si shembull, ai solli faktin se ndërtimi i një impianti për trajtimin e mbetjeve dhe ujërave industriale për një fabrikë të industrisë ushqimore kushton jo më pak se 700 mijë euro, një investim që, sipas tij, është i papërballueshëm për shumë ndërmarrje pa mekanizma të dedikuar mbështetës. Ai kërkoi që strategjia të shoqërohet me objektiva të qarta, afate, buxhete dhe instrumente konkrete financimi që t'u mundësojnë ndërmarrjeve të investojnë në modernizim, ekonominë qarkulluese dhe rritjen e konkurrueshmërisë.

Në përfundim, z. Jaka theksoi se tërheqja e investimeve varet nga garantimi i një mjedisi të favorshëm biznesi, i bazuar në sigurinë juridike, sigurinë e investimit dhe kthimin e parashikueshëm të kapitalit. Ai nënvizoi rëndësinë e forcimit të dialogut ndërmjet administratës dhe biznesit, duke propozuar një bashkëpunim më të ngushtë për të kuptuar sfidat reale të sipërmarrjes dhe për të adresuar vonesat administrative në shqyrtimin e kërkesave të biznesit.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, theksoi se strategjia është mbështetur në një analizë të detajuar të gjendjes së sektorit prodhues, e cila evidenton se industria përpunuese përbën vetëm rreth 6.5% të ekonomisë dhe ka shënuar rënie gjatë vitit të fundit. Sipas tij, objektivi kryesor i dokumentit është zgjerimi i bazës prodhuese, rritja e prodhimit vendas dhe nxitja e eksporteve.

Ai sqaroi se strategjia nuk synon të diktojë se ku duhet të investojë sektori privat, pasi Shqipëria funksionon si ekonomi e lirë tregu, por të krijojë një kuadër politikash që mbështet biznesin dhe e orienton zhvillimin ekonomik drejt standardeve të Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, ai theksoi

se modeli i ardhshëm i zhvillimit duhet të mbështetet në produktivitet, inovacion, tranzicionin e gjelbër dhe atë digjital, duke u larguar nga modeli i bazuar në koston e ulët të fuqisë punëtore dhe aktivitetet me intensitet të lartë karboni.

Z. Kajo theksoi se strategjia nuk krijon institucione apo masa të reja, por synon të koordinojë dhe riorganizojë instrumentet ekzistuese, legjislacionin dhe institucionet përmes bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, sektorit privat dhe akademisë. Ai shpjegoi se dokumenti parashikon ngritjen e mekanizmave për identifikimin dhe mbështetjen e ekosistemeve prioritare, si energjia, turizmi, bujqësia, industria përpunuese dhe lëndët e para kritike, për të cilat Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe përfaqësuesit e biznesit, do të hartojë udhërrëfyes të detajuar të tranzicionit, duke identifikuar sfidat, potencialet dhe masat konkrete për zhvillimin e tyre.

Ai shtoi se strategjia synon gjithashtu të krijojë një kuadër bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike, biznesit, sektorit bankar dhe partnerëve ndërkombëtarë për të mobilizuar investime dhe për të mbështetur zhvillimin e sektorëve prioritarë.

Në përfundim, z. Kajo theksoi se dokumenti nuk është vetëm orientues, por një dokument ligjor që do të shoqërohet me plan veprimi, buxhet, afate, objektiva dhe tregues performance, duke përbërë një angazhim institucional për zbatimin e reformave dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Z. Zak Topuzi, Shoqata Shqiptare e Turizmit, vlerësoi punën e ekspertëve në hartimin e dokumenteve strategjike, por kërkoi që strategjia t'i kushtojë më shumë rëndësi sektorit të turizmit, si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare dhe një kontribues i madh në eksporte. Sipas tij, politikat aktuale nuk e pasqyrojnë plotësisht peshën reale të turizmit dhe ka nevojë për një qasje më të qartë për ta orientuar zhvillimin drejt “turizmit real” dhe jo thjesht investimeve në pasuri të paluajtshme. Në këtë kuadër, ai shprehu rezerva edhe mbi ligjin për investitorët strategjikë, duke theksuar se duhet rishikuar për të orientuar investimet drejt zhvillimit të vërtetë turistik dhe jo kryesisht projekteve të pasurive të paluajtshme.

Ai propozoi forcimin e lidhjes së turizmit me NVM-të, veçanërisht në agrobiznes dhe agroturizëm, si dhe referoi modele ndërkombëtare si Gjermania për rëndësinë e turizmit të brendshëm dhe politikave sektoriale të dedikuara. Gjithashtu, theksoi nevojën për masa konkrete për punësimin në sektor, veçanërisht subvencionimin dhe trajnimin e punonjësve sezonalë për t'i kthyer në fuqi punëtore të qëndrueshme dhe të kualifikuara. Në përfundim, kërkoi që këto masa të shoqërohen me fonde dhe të nisin zbatimin që në vitin e parë të strategjisë 2026–2030.

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, njoftoi se mbledhja e ardhshme e Këshillit do të fokusohet tek standardizimi dhe infrastruktura e cilësisë në turizëm. Ajo vërejtë se sektori i turizmit ka përfituar investime dhe incentiva të konsiderueshme në vitet e fundit, por theksoi se tashmë duhet vlerësuar më seriozisht çështja e produktivitetit.

Sipas saj, këto politika kanë ndikuar edhe në strukturën e tregut, duke çuar nga biznese të vogla drejt kompanive më të mëdha me qeverisje korporative më të fortë, sidomos pas pandemisë. Megjithatë, ajo nënvizoi se pavarësisht këtyre zhvillimeve, sfidat e produktivitetit në turizëm mbeten të rëndësishme dhe duhet të trajtohen më thellësisht në diskutimet e ardhshme të Këshillit.

Znj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, nënvizoi nevojën që strategjitë sektoriale të paraprihen nga një vizion i qartë për strukturimin e ekonomisë shqiptare, duke identifikuar sektorët me potencialin më të lartë për produktivitet dhe zhvillim. Sipas saj, strategjitë duhet të përshtaten me specifikat e ekonomisë shqiptare dhe të mos jenë dokumente me karakter të përgjithshëm, të aplikueshme në çdo ekonomi.

Gjithashtu, ajo rekomandoi që dokumentet strategjike të hartohen në një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke shmangur terminologjinë e ndërlikuar ose të paqartë.

Znj. Ahmetaj vuri në dukje se zhvillimi i ardhshëm ekonomik duhet të mbështetet në një ekonomi të qëndrueshme, të modernizuar dhe të automatizuar, me infrastrukturë që i përgjigjet kërkesave të tregjeve ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ajo informoi se Banka e Shqipërisë është duke finalizuar hartimin e Taksonomisë së Gjellbër, e cila do të shërbejë si udhërrëfyes për sektorin bankar dhe bizneset në orientimin e investimeve drejt aktiviteteve të qëndrueshme dhe në vlerësimin e kostove të tranzicionit të gjellbër.

Në lidhje me aksesin në financë, ajo theksoi se sektori bankar është i vetëdijshëm për rëndësinë e mbështetjes së biznesit, por vlerësimi i rrezikut mbetet parësor për garantimin e sigurisë së depozitave. Ajo nënvizoi se, në mungesë të tregjeve të zhvilluara të kapitalit, sektori bankar mbulon rreth 78% të nevojave për financim të biznesit në Shqipëri, duke konfirmuar angazhimin e tij për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme.

Znj. Elona Lekloti, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA), vlerësoi Strategjinë Kombëtare Industriale dhe Dokumentin e Politikave për NVM-të, duke theksuar se FIAA kishte kontribuar edhe në fazat paraprake të konsultimit. Ajo shpjegoi se shoqata ka paraqitur komente jo vetëm mbi objektivat afatgjata deri në vitin 2030, por edhe mbi nevojën për një analizë të thelluar të mënyrës se si funksionon aktualisht tregu shqiptar.

Ajo kërkoi një ndërhyrje më të koordinuar nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të adresuar problemet strukturore të tregut, duke përfshirë çështjet e konkurrencës, zbatimit të legjislacionit dhe mbikëqyrjes së tregut. Sipas saj, boshllëqet në kuadrin fiskal dhe rregullator krijojnë kushte që cenojnë konkurrencën e ndershme dhe ndikojnë negativisht në mbrojtjen e investimeve vendase dhe të huaja, duke bërë që disa investitorë të rishqyrtojnë praninë e tyre në Shqipëri.

Znj. Lekloti theksoi se Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit duhet të marrë një rol më aktiv si katalizator dhe koordinator ndërinstitucional për adresimin e këtyre problematikave. Ajo argumentoi se strategjia do të jetë efektive vetëm nëse shoqërohet me ndërhyrje konkrete në legjislacionin fiskal, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe funksionimin e tregut, në mënyrë që të krijohet një mjedis më konkurrues dhe më i shëndetshëm për biznesin.

Gjithashtu, ajo nënvizoi rëndësinë e mbrojtjes së investimeve ekzistuese, duke theksuar se investitorët që operojnë sot në Shqipëri janë referenca kryesore për investitorët e rinj të huaj. Sipas saj, përveç aksesit në financë, është e domosdoshme të forcohet edukimi financiar dhe të kufizohen praktikatat e pashëndetshme që shtrembërojnë tregun. Në përfundim, ajo riafirmoi angazhimin e FIAA-s për të kontribuar në përmirësimin e klimës së biznesit dhe shprehu dëshirën që gjithnjë e më shumë produkte të prodhuara në Shqipëri të jenë të pranishme në tregjet evropiane.

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, vlerësoi komentet e përfaqësueses së FIAA-s, duke nënvizuar se instrumentet mbështetëse për industrinë mund të cenojnë ekuilibrat e tregut nëse nuk paraprihen nga një analizë e plotë e situatës aktuale të tregut, investitorëve ekzistues dhe planeve të tyre të investimit. Sipas saj, investimet publike duhet të planifikohen në koordinim me investimet private, duke vlerësuar paraprakisht përfitimet dhe rreziqet, dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit duhet të marrë një rol drejtues për të bashkërenduar aktorët drejt objektivave të Strategjisë 2030.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, theksoi se roli i shtetit në një ekonomi tregu është të lehtësojë dhe të mbështesë zhvillimin e sektorit privat, duke krijuar kushtet e nevojshme për rritjen e tij. Ai nënvizoi se ky është parimi që dallon ekonominë e tregut nga ekonomia e centralizuar dhe se orientimi i politikave të qeverisë është në përputhje me modelin e Bashkimit Evropian, ku shteti vepron si facilitator dhe jo si drejtues i aktivitetit ekonomik.

IV. Komente dhe rekomandime të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve mbi projekt Strategjinë Industriale dhe projekt Politikën për NVM-të 2026–2030

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, theksoi se draft-strategjitë për NVM-të dhe zhvillimin industrial ofrojnë një kornizë të qartë me fokus në konkurrueshmërinë, produktivitetin dhe transformimin ekonomik, si dhe përfshijnë mekanizma monitorimi dhe dialogu publik–privat, duke reflektuar progres në adresimin e sfidave strukturore si fragmentimi institucional dhe mungesa e koordinimit.

Sekretariati thekson nevojën për forcim të bazës analitike përmes të dhënave më të detajuara sipas sektorëve, madhësisë së ndërmarrjeve dhe rajoneve, si dhe qartësim të kuadrit ligjor dhe institucional për zbatim efektiv. Sekretariati thekson gjithashtu rëndësinë e indikatorëve më të fortë të monitorimit dhe raportimit për produktivitetin, eksportet, inovacionin dhe kapitalin njerëzor, si dhe forcimin e dialogut publik–privat në politika dhe zbatim.

Për Strategjinë Industriale, Sekretariati thekson përcaktimin më të qartë të sektorëve prioritarë, mbështetjen e NVM-ve, përmirësimin e aksesit në financë, digjitalizimin dhe inovacionin, si dhe adresimin e mungesës së fuqisë punëtore dhe emigrimit për rritjen e konkurrueshmërisë dhe përafrimin me BE.

Z. Martin Kajo, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, vlerësoi komentet e Sekretariatit, por theksoi se dokumentet janë voluminoze dhe të mbështetura në analiza të thella të përgatitura nga ekipe ekspertësh dhe ministritë. Sipas tij, çdo objektiv dhe masë ka një analizë të vetën dhe metodologjia e përdorur tashmë përfshin prioritizimin dhe zbatimin me faza, edhe nëse kjo nuk është kuptuar plotësisht në komentet e marra.

Ai pranon se disa pjesë mund të duken të paqarta ose të nënkuptuara, veçanërisht në aspektin praktik të zbatimit, por thekson se shumë nga përgjigjet për shqetësimet e ngritura janë tashmë të përfshira në vetë strategjinë. Në këtë kuptim, ai shprehu gatishmëri për rishikim dhe për t’iu përgjigjur komenteve një e nga një, duke sugjeruar se një pjesë e mirë e kritikave burojnë nga moskuptimi i strukturës dhe përmbajtjes së dokumentit më shumë sesa nga mangësi reale.

Mbyllja e mbledhjes

Në mbyllje të diskutimeve, znj. Diana Leka falenderoi pjesëmarrësit për kontributet dhe informoi se të gjitha komentet dhe sugjerimet do të përmbliohen nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në një dokument zyrtar, i cili do t’i përcillet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ekipit të ekspertëve që kanë hartuar strategjitë. Ajo kujtoi gjithashtu se procesi i konsultimit publik mbetet i hapur deri më 2 korrik, duke ftuar të interesuarit të paraqisnin komente shtesë brenda afatit.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Z. Martin Kajo, Zëvendës Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, deleguar nga znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Znj. Elona Lekloti, përfaqësueses, deleguar nga Z. Balazs Revesz, President, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA)
4. Znj. Silva Mecaj, themeluese e Dhomës Shqiptare të Biznesit të Diasporës dhe anëtare e Kryesisë, deleguar nga kryetari i dhomës, z. Ardian Lekaj
5. Z. Grant Van Cleve, President, AmCham
6. Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave, deleguar nga Kryetari i Bordit Mbikëqyrës, z. Bledar Shella
7. Znj. Helisabeta Caco, Drejtore Ekzekutive, deleguar nga z. Denald George Tafani, President, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
8. Znj. Gerta Bilali, CEO, deleguar nga z. Davide Rogai, President, Confindustria Albania
9. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania, deleguar nga kryetari, z. Nicholas A. Rana
10. Z. Bardhyl Baltëza, CEO, Edipack sh.p.k./Kryetar, Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë (*ad-hoc*)
11. Z. Zak Topuzi, CEO, Hotel Mondial/Nën Kryetar, Shoqata Shqiptare e Turizmit (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Znj. Ritva Heikkinen, Shefe e Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
2. Znj. Endrita Xhaferaj, Eksperte e Lartë, deleguar nga znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC

Nuk morën pjesë:

1. Z. Massimiliano Paolucci, Country Manager, Banka Botërore në Shqipërinë
2. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
3. Z. Valer Pinderi, President, Shoqata e Tregtisë Elektronike (AECA)

Të ftuar:

1. Znj. Jenni LUNDMARK, Oficere Programi, Delegacioni i BE-së
2. Z. Serxho Matraku, Shef i Diplomacisë Ekonomike, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
3. Z. Bernard Zeneli, Ekspert Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030 dhe Dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026–2030, GIZ
4. Z. Enton Duro, Ekspert i Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030 dhe Planit të saj të Veprimit, GIZ

5. Znj. Ermonela Myrtezani, Këshilltare, projekti GIZ Proseed
6. Z. Erald Buzi, projekti GIZ Proseed
7. Znj. Florenca Haxhi, CEO, Durana Tech Park
8. Z. Edvin Prençe, Kryetar, Shoqata Pro-Eksport Albania (PEA)
9. Znj. Marjeta Xhabrahimi (Kodra), Shefe Zyre, Advantage Austria
10. Z. Renato Civili, Drejtor i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Gener 2
11. Përfaqësues, Gener 2
12. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
13. Z. Bashkim Sykja, shef kabineti, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
14. Znj. Ema Kasapi, Menaxhere Biznesi, Dhoma Britanike e Tregtisë
15. Znj. Enxhi Duka, Menaxhere Zyre, Dhoma Britanike e Tregtisë
16. Znj. Borana Kalemi, Swisscontact
17. Znj. Klea Rodhani, Specialiste për Çështjet Ligjore, Bordi i Mbikqyrjes Publike (BMP)
18. Z. Gledis Shehu, Ekspert, Albanian Advisers Group
19. Z. Ermal Dajci, Specialist Finance, Korporata e Investimeve Shqiptare